




qendra e provimeve

SHIFRA
E NXËNËSIT




PROVIMI I MATURËS DHE PROVIMI PROFESIONAL

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

JANAR, 2023



* A 1 2 1 1 3 4 6 *



FAQE E ZBRAZËT

LEXO TEKSTIN DHE PASTAJ PËRGJIGJU NË PYETJET 1, 2, 3, 4 DHE 5.

Mjedisi mund te jetojë pa ne, por ne jo pa të...

Ambienti është ai në të cilin njeriu zhvillon veprimtarinë e tij jetësore dhe pa të, ai nuk do të mund të ekzistonte. Duke u fokusuar tek mënyra se si të fitojë më shumë para, njeriu po e anashkalon kujdesin ndaj ekuilibrave natyrorë. Me ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit, dëmtohen e gradualisht shkatërrohen ekosistemet dhe habitoret natyrore të kafshëve dhe bimëve.

Dëmtimi i florës dhe faunës, njëkohësisht sjell përkeqësimin e gjendjes së mjedisit dhe cilësisë së jetës. Duke parë rëndësinë e mjedisit, lind nevoja e madhe për mbrojtjen e tij.

Njeriu e shfrytëzon tokën në favor të interesave të tij, ku gjatë përdorimit ka dhe disa kosto mjedisore, të cilat duhen minimizuar në maksimum.

Ndotja e tokës paraqet ndotjen e sipërfaqes natyrore të Tokës nga aktivitetet industriale, komerciale, shtëpiake dhe bujqësore. Mënyra më e mirë për të parandaluar ndotjen e tokës është përmes menaxhimit të mbeturinave në mënyrë të organizuar, shfrytëzimit të tokës në mënyrë të organizuar dhe praktikave adekuate bujqësore. Në vendin tonë rastet e ndotjes së tokës janë të shumta. Jo te gjithë njerëzit e institucionet veprojnë njëllë ndaj mjedisit. Disa zhvillojnë veprimtari mbrojtëse, ndërsa të tjerët e shfrytëzojnë në mënyrat me barbare atë. Ruajtja dhe kujdesi për mjedisin nuk është vetëm një detyrim shoqëror, por mbi te gjitha është dhe një përgjegjësi individuale.

Mjedisi është i të gjithëve dhe të gjithë duhet ta mbrojnë e atë. Shoqëria si ne vendin tonë ashtu edhe në mbare botën po përballet me problem te mëdha që lidhe me mjedisin si :ndotja, prishja e ekuilibrave të ekosistemeve, shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore etj.

Mjedisi përfaqëson vetë njeriun. Ai pasqyron jetën e njeriut si një libër i hapur. Që ne momentin që lind e deri kur vdes njerëzit janë në kontakt të pandërprerë me mjedisin. Ne nga ai marrim te gjitha elementet e nevojshme për jetën. Me pak fjalë ne ekzistojmë sepse mjedisi ekziston. Natyra na ka falur një të mirë të jashtëzakonshme. Si çdo gjë tjetër të mirë ne ia kuptojmë rëndësinë vetëm në çastin kur e humbasin. E njëjta gjë po ndodh edhe me mjedisin. Pak e nga pak mjedisi po shkatërrohet dhe nuk po i plotëson të gjitha nevojat tona. Në të ardhmen nuk do të mund të plotësojë pothuajse asnjë nga këto nevoja. Jemi pikërisht ne që e kemi çuar në këtë stad, edhe pse deri para pak kohesh nuk e kuptonim.

Marrë nga Interneti www.foltash.com

1. Si po e anashkalon njeriu kujdesin ndaj ambientit natyror duke u nisur nga ajo se pa të nuk mund të jetohet.

1 pikë

2. Çfarë e sjell përkeqësimin e gjendjes së mjedisit dhe cilësisë së jetës?

1 pikë

3. Mjedisi përfaqëson?

1. jetën e njeriut
2. ruajtjen e ambientit
3. mbrojtjen nga fatkeqësitë
4. jetën pa probleme

RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË DHE ZGJIDHJEN BARTE NË FLETËN E PËRGJIGJEVE.

1 pikë

4. A veprojnë të gjithë njerëzit njësoj ndaj mjedisit?

1 pikë

5. Argumento se cila është mënyra më e mirë për mbrojtjen e ambientit dhe mjedisit.

2 pikë

LEXO FRAGMENTIN, PASTAJ ZHVILLO DETYRAT 6, 7, 8 DHE 9.

Nuk kisha dëshirë të shkoja në asnjë zyrë. Isha i lodhur duke ndenjur në kolltuk para shokut Zylo. Veç kësaj më pihej një kafe. Kështu që pas tij dola edhe unë. Hyra në kafe “Tirana” dhe u ula në një tavolinë përballë dritares. Duke ndenjur i menduar fillova të qeshë me vete: “Për mua shoku Zylo është fenomenal. Me shumë njerëz kam punuar. Shumë njerëzve ua di psikologjinë, karakterin, tekat. Por njerëzit që kam njohur nuk mund të krahasohen me shokun Zylo. Si do të më shkojë puna me të vallë? Më duket se ky do t’i shkruajë vetë referatet dhe raportet, unë vetëm do t’i mbledh të dhënat. Të paktën kështu do ta kem më lehtë...” – mendova i ulur në tavolinë – “kurrizi yt, o Demkë do t’i mbajë të gjitha letrat e nxira të futura në dosjet e bardha!” Tek rrija në tavolinë, pashë nga dritarja Bakirin, një nga kolegët e mi. Ai më vuri re dhe u kthye.

– Ne thamë se do të punoje në zyrën tonë; ti e paske punën me shefat, – tha ai.
 – U paraqita për herë të parë.
 – E, të dha udhëzimet?
 – Biseduam, – u përgjigja.
 – T’i tregoi studimet e para në “prizmin shkencor?” – qeshi ai.
 – Folëm për gjëra të tjera, – thashë, pasi nuk doja ta merrja nëpër gojë shokun Zylo.
 – Po partiturat e Diogjenit t’i tregoi? – pyeti ai përsëri.
 – Jo.
 – Çudi! Ai i mban në çantë..., – tha Bakiri duke qeshur.
 – Do të merrni një kafe? – e pyeta.
 – Asgjë nuk do të marr, – tha ai. – E njihnit mirë më parë shokun Zylo? – shtoi.
 – Pak.
 – Unë e njoh mirë. Dikur kam pasur mjaft miqësi. Ai kujton se unë tallem me të dhe është larguar, – tha Bakiri.
 – Keni qenë edhe më parë bashkë në ndonjë punë?
 – Kemi qenë në një klasë në shkollë. Pastaj ai u ngrit në përgjegjësi. Megjithatë, përsëri vazhdoi miqësia jonë. Edhe tani kemi njëfarë miqësie.
 Heshtëm për një çast. Nga dritarja frynte një erë e ngrohtë. Perdja e hollë lëkundej dhe herë pas here më binte në fytyrë.
 – Ëndrra e shokut Zylo është të emërohet ambasador në ndonjë vend të Evropës, – tha Bakiri.

6. Shkruaje titullin e veprës, emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

1 pikë

7. Rrëfyeni në këtë fragment është:

1. Shoku Zylo
2. Demka
3. Bakiri

RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË DHE ZGJIDHJEN BARTE NË FLETËN E PËRGJIGJEVE.

1 pikë

8. Cilat teknika të rrëfimit përdor shkrimtari në këtë fragment?

1 pikë

9. Rretho numrin pranë cilësisë që e karakterizojnë shokun Zylo dhe zgjedhjen barte në fletën e përgjigjeve:

1. naiv dhe tragjikomik
2. punëtor i zellshëm
3. besnik në punë
4. i guximshëm

1 pikë

LEXO FRAGMENTIN NGA “KOMEDIA HYJNORE” DHE PËRGJIGJU PYETJEVE 10, 11, 12 DHE 13.

Kënga XXVI

O vllazën, thashë, që nimijë krajata
Arritun keni deri në perëndim;
Kësaj çikë jete me ndjesi të ngrata

Që tashma gjindet gati në mbarim
Tue ndjekun diellin, ju mos ja mohoni
Njohjen botës ku nuk ka njerëzim

Prej çfarë jeni s’duhet ta harroni:
Ju s’keni lindë veç sa me ngranë si shtasë
Po që virtyt e dituni t’i doni.

10. Komedia Hyjnore është:

1. prozë
2. poemë
3. dramë
4. tragjedi

RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË DHE ZGJIDHIEN BARTE NË FLETËN E PËRGJIGJEVE.

1 pikë

11. Lloji i strofës që e përdor poeti në vepër është:

1 pikë

12. A) Përse Dante e zgjodhi pikërisht Virgjilin të jetë shoqëruesi i tij gjatë udhëtimit të tij?

2 pikë

B) Kë donte të takonte Dante në Parajsë?

1 pikë

13. Rretho personazhet që nuk bëjnë pjesë në “Komedinë Hyjnore”.

Virgjili Antigona Beatricja Mefistoteli

1 pikë

14. Plotëso tabelën siç kemi filluar.

| VEPRA | AUTORI | GJINIA LETRARE | PERIUDHA LETRARE |
|-------------------------|---------------|----------------|------------------|
| <i>Libri i këngëve</i> | | Lirike | |
| <i>Lahuta e Malcisë</i> | Gjergj Fishta | | |
| <i>Pas vdekjes</i> | | | Realizmi |
| <i>Iliada</i> | Homeri | | |

2 pikë

15. Vetëm njëra nga këto karakteristika ka të bëjë me personazhin Dr. Gjilpëra, veçoje atë dhe argumento përgjigjen tënde.

Njeri i përbuzur

Degradues i vendit

I përfolur për veprimet dashakeqëse

Njeri me ambicie për zhvillimin e vendit të tij

2 pikë

LEXO FRAGMENTIN NGA “VDEKJA E NOSITIT” DHE ZHVILLO DETYRAT 16, 17 DHE 18.

Me zjarr ju flas... me zjarr
Në gjirin tim kam hapur varr...
Që t’i jap shpresë- edhe t’ja marr...

Un’ ik liqerit zemërak
Fatlum dh’ i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:

Se vijnë- urtuar zogjtë-e mi,
Dh’u jap ushqim me dashuri-
Një dashuri për llaftari:

Pa nis ah! Gjirin ta godas...
Dh’e hap ah! gjirin për një ças...
Dh’i nginj ah! zogjtë- e vdes me gas!...

16. Trego se kë identifikon Nositi dhe kë liqeni:

Nositi - _____

Liqeni - _____

2 pikë

17. Argumento pse poezia “Vdekja e Nositit” është lirikë filozofike:

2 pikë

18. Me cilën figurë stilistike e titullon autori poezinë?

1 pikë

19. Foljes së nënvizuar ndërtoj caktoja:

Kohën _____

Formën _____

Mënyrën _____

1 pikë

20. Disa nga fjalët e mëposhtme janë shkruar gabim. Rishkruaji saktë ato.

1. Anije _____

2. Kriuar _____

3. Gjithëçka _____

4. Prapë se prapë _____

5. E sotmja _____

1 pikë

21. A) Fjalinë e mëposhtme ktheje në ligjëratën e zhdrejtë:

Unë betohem: "Herën tjetër do të them vetëm të vërtetën!".

1 pikë

B) Argumento ndryshimet:

1 pikë

22. Shpjego shprehjet frazeologjike:

I ra bisht punës _____

Më preu në besë _____

2 pikë

23. Rishkruaje tekstin duke respektuar drejtshkrimin.

E merrja me mend se si pikatë e panumërta rrokulliseshin tani në faqet e pjerrëta të çatis tonë, duke shpejtuar të binin sa më parë në tokë, që pastaj të avulloheshin dhe të ngjiteshin prapë atje lart, në qiellin e bardh. Ato nuk e dinin se në strehët e çatis i priste një grack e panjohur, qyngji prej llamarine.

2 pikë

24. Shkruaj një ftesë zyrtare në të cilën drejtorja e Teatrit të Shkodrës “Migjeni” fton Teatrin e Tuzit “Malësia” që të bëjë hapjen e javës së kulturës në Shkodër, ku do të japin shfaqjen e bazuar nga “Koprraci” i Molierit me datën 21.05.2021 në orën 19:00. Shfaqja do të mbahet në sallën e shtëpisë së kulturës në Shkodër ku do të jenë të pranishëm edhe trupa e Teatrit Kombëtar të Tiranës dhe Teatrit “Dodona” të Prishtinës.

Respektoni formën e tekstit, me të gjitha të dhënat e domosdoshme që duhet t’i ketë një LETËR ZYRTARE si dhe respektoni gjuhën standarde.

8 pikë

25. Janë dhënë dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

- Me rastin e zhvillimit të temës, shfrytëzo shembujt relevant/të dhënat dhe argumente qëndrimet personale.
- Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHE FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi). Eseja DUHET të shkruhet në fletët e parapara për shkrimin e esesë (eseja e shkruar në fletët e konceptit NUK LEXOHE).
- Bëj kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

1. Migjeni dhe revolta e tij

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Shkruaj se përse është i revoltuar poeti pothuajse në çdo varg të tij. Duke pasur parasysh situatën në Shqipëri gjatë shekullit të XX.
- Tema kryesore e krijimtarisë së Migjenit është mjerimi, përshkruaj se si i paraqet autori *heronjtë* e tij tek "Poema e Mjerimit".
- Shkruaj disa pasoja që shkakton mjerimi duke marrë së paku një shembull.

2. Koha e çmuar sa vetë jeta ...

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Tregoni si e konceptoni ju termin kohë; ç' është koha për ju?
- Çfarë përbën vlerë sot: telefoni, koha, paraja apo dituria?
- Trego se në cilin rast teknologjinë e kemi mik dhe në cilin rast armik.

13 pikë

